



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. ____ prot.

Tiranë, më 18.2.2020

Lënda: Parashtrimet përfundimtare të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 18.2.2020, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit z. Besnik Cani, konfirmuar në detyrë me vendimin nr. 84, datë 27.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, pasi u shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha shkaqet e ankimit, prapësimet e palëve dhe provat e administruara, Komisioneri Publik, në përfundim, duke iu përmbajtur parashtrimeve të paraqitura në këtë gjykim, konstaton se pretendimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e secilit shkak ankimi.

Nga vlerësimi tërësor i akteve të administruara në gjykimin e kësaj çështjeje nga ana e këtij trupi gjykues, Komisioneri Publik çmon se të gjitha shkaqet e ankimit të ushtruar kundër vendimit të Komisionit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, referuar edhe përmbajtjes së rekomandimit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, mbeten për t’u shqyrtuar dhe vendosur mbi to nga ana juaj.

Për Komisionerin Publik, shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje nga ana juaj, mbi bazën e shkaqeve të ankimit, bazuar në nenin 179/b, pika 5, të Kushtetutës, nenin C, pika 2, nenin F, pika 2 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, provoi se:

I. Për sa i përket kriterit të pasurisë

1. *Lidhur me pasurinë 1, apartament banimi me sip. 104.77 m², ndodhur në Tiranë, subjekti i rivlerësimit gjendet:*

(i) në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme **(i.i)** në shumën - 484,665 lekë, për pagesën e këstit të parë dhe në shumën **(i.ii)** 6.000 euro, për pagesën e datës 31.1.2006;

(ii) nuk provohet pretendimi i subjektit për përdorimin e depozitës në vlerën 50.000 lekë, për pagimin e këstit të parë, si dhe

(iii) ka kryer deklaram të pasaktë, si në deklaratat periodike vjetore dhe në atë “Vetting”, lidhur me marrëdhëniet e huave të deklaruara si burim i krijimit të pasurisë.

Në këto kushte, për këtë pasuri, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme dhe ka kryer deklaram të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

2. *Lidhur me pasurinë 2, “Truall” me sip. 633.8 m² dhe një “banesë private”, ndodhur në ***, nga shqyrtimi gjyqësor, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë vlerën e saktë të investimit të kryer për krijimin e kësaj pasurie, duke mos provuar plotësisht burimin e ligjshëm të krijimit të saj, në kuptim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.*

3. *Lidhur me pasurinë 3 (Autoveturë) dhe 4 (Garazh), bazuar në nenin 32/5, të ligjit nr. 84/2016, nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore rezultoi se:*

(i) subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë, pasi në deklaratën periodike vjetore nuk ka deklaruar burimin e krijimit për secilën nga këto pasuri, si dhe

(ii) ka mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e këtyre dy pasurive, pasi nga analiza financiare për periudhën 2010 – 2015, rezulton se në vitin 2012, vit në të cilin janë blerë këto pasuri, subjekti nuk mbulon me burime të ligjshme shpenzimet dhe investimet e kryera në këtë vit, për një diferencë negative prej - 517.209 lekësh.

4. Lidhur me analizën financiare (2010 – 2015)

4.1 Komisioneri Publik, pasi analizoi dhe mori parasysh provat e depozituara dhe prapësimet e subjektit gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, sikundër u analizua edhe në parashtrimet e datës 11.2.2020, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit për periudhën 2010 – 2015, nuk mbulon me burime të ligjshme shpenzimet dhe investimet e kryera për një diferencë negative në shumën - 2.085.463 lekë.

4.2 Për sa më sipër, konstatojmë se, edhe pas hetimit të shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik nga ky trup gjykues, prapësimet dhe aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në kuptim të detyrimit për të provuar të kundërtën, nuk arritën të provojnë bindshëm burimin dhe të ardhurat e ligjshme të krijimit të pasurive të deklaruara. Duke mos plotësuar kështu kërkesat e nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

II. Për sa i përket kriterit të aftësive profesionale (etika, figura)

5. Në referencë të shkaqeve të ankimit dhe prapësimeve, dhe akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë këtij gjykimi, Komisioneri Publik çmon se konfirmimi në detyrë i subjektit të rivlerësimit nga ana e Komisionit si për sa i takon aftësive profesionale, por edhe në një vlerësim tërësor të procedurave, në kuptim të nenit 4, pika 2, lidhur me nenin 61, pika 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016, është marrë në interpretim të gabuar të ligjit dhe provave të administruara.

6. Ky vlerësim mbështetet në rezultatet e hetimit administrativ të katër çështjeve/praktikave, të cilat Komisioni ka vendosur t'i transferojë pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore¹.

7. Gjatë debatit gjyqësor të palëve në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, parashtroi se ankimi i Komisionerit Publik, për këto çështje nuk duhet pranuar, duke interpretuar zbatueshmërinë e nenit 59, pika 4, të ligjit nr. 84/2016.

8. Komisioneri Publik rithekson edhe njëherë qëndrimin e tij, të cilin e ka argumentuar gjerësisht në ankimin e tij, se ndalimi i së drejtës së ankimit, parashikuar në nenin 59, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, nuk gjen zbatim dhe nuk ndikon në të drejtën e Komisionerit Publik për të ushtruar ankim, kur në cilësinë e një prej tri institucioneve të rivlerësimit, përfaqësues i interesit publik për qëllim të nenit 179/b, të Kushtetutës, konstaton se vendimmarrja e Komisionit nuk është marrë në përputhje me ligjin dhe nuk mbështetet në prova apo subjekti nuk plotëson kushtet që të përliqë konfirmimin të tij në detyrë.

9. Duke iu rikthyer katër çështjeve të transferuara nga Komisioni, në vlerësimin tërësor të çështjes në lidhje me elementet e rivlerësimit që kanë të bëjnë me etikën dhe figurën e magjistratit, si pjesë e vlerësimit të kriterit profesional, marrë në konsideratë shkaqet e parashtruara në ankimin e Komisionerit Publik, bazuar në nenin 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, arrijmë në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e nenit 61, pika 4 dhe 5, të këtij ligji, pasi me veprimet dhe mosveprimet e tij, si në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, ashtu edhe të prokurorit të çështjes, rezultoi se nga shqyrtimi gjyqësor dhe në analizë të:

(i) situatës faktike dhe ligjore të marrëdhënies kontraktuale të subjektit me shoqërinë “****” SHPK, dhe

(ii) rrethanave faktike dhe ligjore të përfitimit të statusit të pastrehë,

subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë provë të re dhe pretendimet e tij mbeten të nivelit deklarativ.

¹ a) Marrëdhënia juridiko-civile ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me shoqërinë “****” SHPK; b) Procedimi penal nr. ***, viti 2006, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë; c) Procedimi penal nr. ***, viti 2012, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, së bashku me praktikën për përfitimin e statusit të pastrehë nga subjekti, si dhe d) Procedimi penal nr. ***, viti 2015, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Në rastin e përfitimit të statusit të familjes së pastrehë, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën apo të justifikojë padijeninë e tij për faktin që, ndërkohë kur kryente detyrën e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, ndërsa kjo prokurori ishte duke hetuar praktikën e pretenduar të paligjshme të ndjekura nga strukturat e Bashkisë Fier për kreditë e buta (2012 – 2014), familja e tij (e subjektit të rivlerësimit) shpallet e kualifikuar me statusin “e pastrehë” (mars 2013) nga kjo Bashki, në kundërshtim me përcaktimet ligjore, për t’u trajtuar me kredi.

9.1 Për sa më sipër, Komisioneri Publik rithekson qëndrimin e tij, se rrethanat e provuara në këto dy çështje, të cilat lidhen me veprimet apo mosveprimet e subjektit të rivlerësimit, bien ndesh me detyrimet ligjore për magistratin, të tilla që mjaftojnë për t’u vlerësuar si rrethana papajtueshmërie në ushtrimin e funksionit të prokurorit në rastin konkret.

10. Në këtë kontekst, të njëjtin qëndrim me shkaqet e ankimit dhe sa kemi parashtruar gjatë gjykimit në Kolegj, mbajmë dhe për dy çështjet penale, atë me nr. ***/2006, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe atë me nr. ***/2015, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Pasi Komisioneri Publik vlerëson se përfundimet e arritura nga Komisioni nuk janë të bazuara në raport me vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, referuar nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

11. Në vlerësim të drejtë të katër çështjeve të sipërpërmendura me dispozitat ligjore në fuqi, Komisioneri Publik, në konsideratë të shkaqeve të ankimit dhe të përmbajtjes së rekomandimit të ONM-së, marrë në konsideratë rolin orientues të jurisprudencës së Kolegjit në procesin e rivlerësimit, kërkon që ato të shqyrtohen dhe vlerësohen brenda juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit, dhe bazuar në nenin 66, të ligjit nr. 84/2016, Kolegji, pasi t’i marrë në shqyrtim dhe t’i gjykojë ato, të mund të shprehet dhe për çështjet si vijojnë:

11.1 A mundet Komisioni të heqë dorë nga juridiksioni i tij rivlerësues në lidhje me vlerësimin e kriterit profesional, kur sipas Kushtetutës, aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016, është kompetencë e plotë dhe detyrë e tyre (e institucioneve të rivlerësimit) kryerja e rivlerësimit kalimtar të subjekteve sipas nenit 179/b, pika 1 e Kushtetutës? Përpara se Komisioni t’ia transferojë çështjet një tjetër organi kompetent për inspektim, kjo vendimmarrje a duhet të udhëhiqet nga një proces paraprak vlerësimi lidhur me plotësimin e kushteve që neni 59/4 i ligjit nr. 84/2016 kërkon, të tilla si [...] *“evidentimin e shkaqeve që përbëjnë shkelje disiplinore”* apo *“shkaqeve për t’u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të subjektit”* [...]?

11.2 Në çdo rast, kjo lloj vendimmarrje e institucioneve të rivlerësimit, sipas nenit 59/4, të ligjit nr. 84/2016, a do të duhet të ketë një kufizim në lidhje me numrin e çështjeve/praktikave që mund t’i transferohen organit kompetent për inspektim?

III. Kërkimi përfundimtar i ankimit

12. Në përfundim të këtyre parashtrimeve, në vlerësim edhe të përmbajtjes së rekomandimit të ONM-së, Komisioneri Publik vlerëson se:

12.1 *Për kriterin e pasurisë*, në interpretim të pikës 3, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të nenit 33, dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve financiare dhe nuk arrin të justifikojë burimin e ligjshëm të

krijimit të pasurive të deklaruara prej tij dhe personave të lidhur me të, duke kryer kështu deklaram të pamjaftueshëm;

12.2 *Për kriterin e aftësive profesionale dhe nga vlerësimi tërësor i çështjes*, në interpretim të nenit E, të aneksit të Kushtetutës, nenit 4, pika 2, lidhur me nenin 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit duhet të gjejë zbatim neni 61, pikat 4 dhe 5, të këtij ligji.

12.3 Komisioneri Publik, duke nënvizuar se çështjet e transferuara tek organi disiplinor, në rastin konkret, duhen konsideruar se përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara nga dispozitat e nenit 61, pikat 4 dhe 5, në konsideratë të rolit kontrollues dhe orientues, sipas nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkon që Kolegji të shprehet mbi pyetjet e ngritura si më sipër, me qëllim orientimin e ecurisë së mëtejshme të procesit të rivlerësimit për raste të ngjashme, për kuptimin dhe zbatimin e nenit 59, të ligjit nr. 84/2016;

12.4 Bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkojmë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 84, datë 27.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Cani, magjistrat/prokuror, anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA